



Oxidol Minio

Minio kundër gërryerjes
me cilësi të lartë



Rendimenti i mbulimit: 13 - 15
m²/lt



Koha e tharjes: 1½ - 2 orë.
Thahet plotësisht pas 3 - 4 orësh



Hollimi: deri në 5% për vëllim në
White Spirit për aplikim me furçë/rul, ose
deri në 20% në Holluesin nr. 1 për aplikim
me pistoletë me spërkatje



Mundësia për shtresë të dytë:
10 - 16 orë



Paketimi: 750 ml, 2,5 lt

Aplikimi: Me furçë, rul, pistoletë me
spërkatje

KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Astar i shkëlqyer kundër gërryerjes i llojit MINIO, me përmbajtje të ulët POA. Mund të përdoret për të lyer me astar çdo lloj sipërfaqeje prej hekuri. Arrin mbrojtje efikase kundër gërryerjes edhe në sipërfaqet e ekspozuara ndaj një ambienti të fortë oksidues. Ngjitje e shkëlqyer. Nuk përmban pigmente toksike kundër gërryerjes. Mundëson punim të thjeshtë dhe përhapet mrekullisht mirë. Tharje e shpejtë.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Shkëlqimi	Mat me indeks shkëlqimi prej <3 në 60°.
Graviteti specifik	1,33 - 1,38 kg/lt.
Rendimenti i mbulimit	13 - 15 m ² /lt për shtresë, në një sipërfaqe të p duhet.
Hollimi	Për aplikim me furçë ose rul deri në 5 % për vëllim në SMALTOLUX WHITE SPIRIT. Për aplikim me pistoletë të zakonshme ose me spërkatje pa ajër deri në 18% për vëllim në holluesin nr. 1 VECHRO.
Koha e tharjes	Sipërfaqja thahet për 1 ½ - 2 orë. Thahet plotësisht pas 3 - 4 orësh.
Mundësia për shtresë të dytë	Mund të lyhet përsëri pas 10 - 16 orësh. Rekomandohet të jepet shtresa e dytë pasi shtresa e parë të jetë forcuar plotësisht. Afatet e mësipërme kohore janë më të gjata në kushte të ftohta moti dhe me lagështirë.
Kategoria e POA	A. "Veshje të veçanta me një përbërës. Astar me substrat hekuri". Lloji D. Vlera e pragut të POA = 500 gr/lt. Përmbajtja maksimale e POA për produktet e gatshme = 450 gr/lt. Boja gjithashtu përmban tretës jo POA. POA: përbërësit organik të avullueshëm me pikën e zierjes < 250 °C.
Ngjyra	Portokalli



PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Sipërfaqja duhet të pastrohet nga pluhuri, yndyrat, vaji, bojërat e mëparshme të lirshme, ndryshku; aplikoni letër smerili dhe pastroni tërësisht pluhurin.

APLIKIMI

Përziheni mirë. Aplikoni një ose dy shtresa Oxidol Minio. Si ngjyrë përfundimtare mund të aplikohet Gumilak metal, Smaltolux extra ose Smaltolux hydro rast pas rasti.

PASTRIMI I MJETEVE

Gjatë punës, mbajini mjetet "të njoma" në enë ose në tabakanë me bojë. Kullojeni bojën mirë nga mjetet kur ta hidhni përsëri në kuti dhe pastrojini ato me ujë të ngrohtë me sapun. Nëse boja thahet, ajo mund të hiqet vetëm me detergjente të fortë. Mos i zbrazni ujërat që keni larë mjetet në ujërat nëntokësorë.

KUSHTET E APLIKIMIT

Temperatura 8 - 30 °C dhe niveli relativ i lagështisë më i ulët se 80 %. Kushtet e këqija gjatë aplikimit mund të ndryshojnë vetitë e produktit në fund.

RUAJTJA

Ruajini në një vend të freskët, mbroni materialet nga ngrirja dhe ekspozimi në diell. Mbylleni fort enën pas aplikimit. Rimerreni bojën që ka tepruar për ta përdorur përsëri. Ripërdorimi i ngjyrave mund të minimizojë ndjeshëm efektet në mjedis të ciklit të jetës së produkteve.

SHËNIME

Mund të gjeni më shumë informacion në Fletën e të Dhënave të Sigurisë së Materialit të produkteve (FDSP).

UDHËZIME PËR PËRDORIM TË SIGURT

Lexoni etiketën përpara përdorimit. Mbajeni larg fëmijëve.



Të dhënat dhe udhëzimet teknike në këtë broshurë teknike bazohen në testet laboratorike dhe janë rezultat i njohurive dhe përvojës së stafit shkencor të shoqërisë. Cilësia e produktit garantohet nga shoqëria, i cili është në përputhje me kërkesat e ISO 9001,14001 dhe me rregulloren e EMAS. Si prodhues, ne nuk mbajmë asnjë përgjegjësi për asnjë dëm apo dëme të shkaktuara nëse produkti nuk është aplikuar për përdorimin e duhur dhe në përputhje me udhëzimet për përdorimin.